



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:076350

Datë: 29.05.2019

Numri i dokumentit: 00336232

P.nr.167/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rilind Sermahaj, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Donika Latifi, në çështjen penale kundër të pandehurës M. M. nga fshati, Komuna e Gjilanit, për shkak të veprës penale sulmi, nga neni 187 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, me numër PP.II.nr.248/2019, të datës 19.02.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën 21.05.2019, mori dhe publikisht, shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

E pandehura M. M., nga babai dhe nëna, e lindur, i lindur me datë në Gjilan, me vendbanim në fshatin, Komuna e Gjilanit, ka të kryer shkollën e fillore, e martuar,, e pa punë, e gjendjes së varfër ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, e identifikuar me numër personal

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 10.02.2019, në fshatin, Komuna e Gjilanit, në shtëpinë familjare, e pandehura me dashje dhe me qëllim të shkaktimit të dhembjes, mundimit, frikës, përluljes dhe shqetësimit të djalit të saj të mitur L. M., ka shkaktuar dhunë në familje, duke sulmuar fizikisht të njëjtin pa pëlqimin e tij, në kundërshtim me nenin 2 nën paragrafin 1.2. pika 1.2.4 të Ligjit për Dhunën në Familje, në atë mënyrë që për shkak se kishte parë duke konsumuar duhan, sapo i njëjti ishte futur në dhomën e tij në shtrat, e pandehura i kishte hy në dhomë dhe i kishte kërkuara sqarim për këtë me ç'rast edhe ishte nervozuar dhe kishte sulmuar fizikisht duke e goditur me shuplaka fytyrës, më pas kishte dalë nga dhoma dhe ishte kthyer me një shkop të vogël me të cilin e kishte goditur njëherë në themra dhe një herë në kokë dhe në këtë mënyrë tek e dëmtuara ka shkaktuar frikë, dhimbje, mundim dhe shqetësim të madhe emocional.

-Me çka ka kryer veprën penale, sulmi nga neni 187 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4,41,42,49,50,51,52,73,74,75 dhe 76 të KPRK-ës dhe neneve 248 e 365 të KPP-ës, të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që të pandehurës M. M. i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e pandehura në periudhën kohore prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

Përfaqësuesi ligjor i të miturit L. M., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

Obligohet e pandehura e lartcekur që të paguaj shpenzimet procedurale sipas përlllogaritjes përfundimtare të kësaj gjykate si dhe paushallin gjyqësorë në shumë prej 20 € (njëzetë euro), të gjitha këto brenda afatit 15 ditëve nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë, në kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A R S Y E T I M

1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 19.02.2019, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr. 248/2019, kundër të pandehurës M. M. nga fshati, Komuna e Gjilanit, për shkak të veprës penale sulm, nga neni 187 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Më datë 21.05.2019, në këtë gjykatë është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezent prokurorja e shtetit Bahtije Ademi, e pandehura M. M., dhe i dëmtuari i mitur L. M., në të cilën seancë e pandehura pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila i vihet në barrë me çast gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 248 paragrafi 1 të KPRK-ës, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurës.

2.Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në të cilin kanë qenë palët e lartcekura, pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë në kuptim të nenit 248 paragrafi 1 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezente. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se e pandehura nuk ka qenë e detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmbanë aktakuza dhe se aktakuza nuk përmbanë asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se e pandehura M. M. ka kryer veprën penale sulm, nga neni 187 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit ka vlerësuar se të pandehurit duhet ti shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e pandehura në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë veprë

tjetër penale ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit dhe si i tillë me këtë dënim mund të arrihen qëllimet e dënimit në kuptim të nenit 41 të KPRK-ës i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 73,74,75 dhe 76 të KPRK-së, ashtu që rrethanë posaçërisht lehtësuese ka marrë faktin se e pandehura ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë në një fazë të hershme të procedurës penale, se e njejta është penduar dhe ka shfaqur keqardhje për veprimet e saj, ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale, si dhe faktin të njejtit më parë nuk kanë pasur probleme në mes vete dhe se të njejtit ende vazhdojnë të jetojnë në harmoni të plotë edhe pas këtij rasti, po ashtu gjykata ka marrë parasysh edhe rrethanat personale dhe karakterin e të pandehurës ku nga shkresat e lëndës shihet se për të është hera e parë që bie ndesh ligjin ndërsa si rrethanë rënduese gjykata parasysh faktin se nga verpimet e të pandehurës tek i dëmtuari i mitur L. është shkaktuar frikë, ankth, dhembje dhe shqetësim i madh emocional të cilat edhe mund të ndikojnë negativisht në formësimin e personalitetit të të dëmtuarit, e gjitha kjo duke pasur parasysh se i dëmtuari është i mitur andaj gjykata konsideron dënimin i shqiptuar ndaj të pandehurës së lartcekur duke i marrë parasysh rrethanat e përmendura më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurës.

5. Vendimi lidhur më kërkesën pasurore juridike

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, përfaqësuesi ligjor i të miturit Leutrim- Ali Mustafa, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

6. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurës, gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-ës, ka vendosur që të pandehurën ta detyrojë t'i paguajë shpenzimet procedurale sipas përlllogaritjes përfundimtare nga ana e gjykatës si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzet euro) në afat prej 15 ditëve nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.167/2019, me datë 21.05.2019

Procesmbajtësja,
Donika Latifi

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Rilind Sermaxhaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njejtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.